

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 5668, datë 20.11.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 12.2.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE
E MINISTRISË SË DREJTËSISË, SHËRBIMIT PËRMBARIMOR SHTETËROR,
PROKURORISË, NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 pika 1 shkronja “ç” të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimi Përmbarimor Shtetëror, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, shkronja A e shtojcës 1, zëvendësohet me shkronjën A të shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

SHTOJCA 1

**TARIFA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA GJYQËSORE,
MINISTRIA E DREJTËSISË, PROKURORIA DHE NOTERIA**

	Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
A. Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:		
1 Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit	200	
2 Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit	200	
3 Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore	200	
4 Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Punëve të Jashtme	200	
5 Për lëshimin e vërtetimit së ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria	200	
6 Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria	200	
7 Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata së kërkuesi nuk është në proces gjyqësor	200	
8 Kërkesëpadi që paraqiten në gjykate:		

	a) për pension ushqimor	0	
	b) për vërtetim fakti	200	
	c) padi për zgjidhje martesë	3000	
	ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	3000	
	d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi:		
	I) me vlefte deri 100 000 lekë	3000	
	II) me vlefte mbi 100 000 lekë		1%
	dh) padi për përpjesëtim pasurie	3000	
	e) padi për kthim në punë	0	
9	Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës	200	